

# BASHKË MUND TË



# ARRIJMË TEK YJET

## NE JEMI ATA TË CILËT VENDOSIM

LORIK (14), ARBNOR SH. (15), ARBNOR D. (14), BLERTINA (14), ALKETA (14), BLEONA (15), ANITA (14),

FJOLLA (13)



### Disa fakte rreth demokracisë dhe prejardhjes së saj

Demokracia është formë e qeverisjes, ku të gjithë qytetarët gëzojnë të drejta të barabarta në vendim-marrje. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Demokracia është shfaqur qysh në kohën e antikitetit, në Greqinë e lashtë, në vitin 507 p.e.s. Si babai i demokracisë njihet Klisteni.



Barazia, synim i demokracisë

### Si lidhet demokracia me jetën tonë dhe çfarë roli kemi ne në demokraci?

Përgjigjen e kësaj pyetje, po fillojmë ta tregojmë me një shembull. Kështu, në një shkollë të Kosovës kishte një numër mjaft të madh nxënësish, etniteti i të cilëve nuk ishte i njëjtë. Anna dhe Tony ishin dy nxënës, të cilët e kishin prejardhjen nga Anglia. Shu-


micës së nxënësve nuk iu pengonte aspak kjo dukuri, por disa prej tyre nuk sillleshin mirë me ta. Ata ndiheshin të diskriminuar në raport me të tjerët, dhe dukej sikur mendimet e tyre nuk merreshin parasysh. Në lojë përfshiheshin ndonjëherë të gjithë, përveç Anna-s dhe Tonny-t. Me kalimin e kohës, raporti i nxënësve nuk po përmirësohej. Një ditë prej ditësh, një grup shokësh të cilët e kuptonin më mirë këtë gjendje, vendosën t'i vetëdijësojnë të tjerët si dhe t'i informojnë ata se në demokraci të drejtat e të gjithëve janë të barabarta, pa dallim feje, race, etniteti, etj. Kështu, të gjithë e kuptuan se veprimet e tyre nuk ishin të mira dhe filluan të ndryshonin qasjen që e kishin ndaj dy shokëve me etnitet tjetër. E mira e kësaj pune ishte se mesazhi nuk ngeli vetëm për nxënësit e asaj kohe, por edhe për gjeneratat e tjera, duke kuptuar gjithnjë e më shumë vlerën e respektimit të të drejtave të secilit.



Ne jemi e ardhmja e vendit, prandaj bashkëpunimi dhe respekti për njëri-tjetrin është mbi të gjitha

# ZGJEDHJA ËSHTË E LIRË

FLORESA (14), BESJAN (14), DION (14), LORIK J. (14), ANTIGONA (15), ANITA (14), ELSA (14), SHQIPDONA (14)




Në këto vizatime shokët tanë kanë paraqitur se si qytetarët në demokraci janë të lirë t'i jetësojnë të drejtat e tyre. Demokracia është shtëpia e të gjithë qytetarëve

**Demokracia është sistem ku të gjithë qytetarët janë të lirë të vendosin për veten dhe të ardhmen e tyre. Për mënyrën se si qytetarët e mendojnë dhe zgjedhin më të mirën për ta, do të informoheni gjatë leximit të artikullit tonë**

Lexues të dashur, unë Dioni bashkë me shokët e mi sot kemi përjetuar një ditë me plot emocione dhe kemi marrë shumë informata të reja për shumë tema. Një ndër temat që e diskutuam më së shumti ishte demokracia dhe e drejta për të/t'u zgjedhur. „Çka është e drejta për të/t'u zgjedhur?“, pyeti Floresa. Unë iu përgjigja: „Kjo është e drejta për të marrë pjesë në procesin zgjedhor. Pra, të drejtën për të kandiduar apo për të votuar e gëzon secili qytetar, mbi moshën 18 vjeçare.“ Kjo falë sistemit të demokracisë. Në këtë sistem, të gjithë qytetarët e kanë të drejtën e zgjedhjes, çfarëdo zgjedhje qofshin ato. Është me rëndësi të ketë zgjedhje, sepse prej tyre zgjedhet kandidati më i suksesshëm dhe personi më i denjë në punën e tij. Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Në zgjedhjet lokale zgjedhet kryetari i komunës dhe asamblistët. Kurse, në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët. Zgjedhjet bëhen përmes votave. Vota duhet të jetë e fshehtë, e lirë dhe nuk duhet të imponohet, në mënyrë që të përzgjedhet më i miri. Të gjithë qytetarët kanë të drejtën e votës mbi moshën 18 vjeçare. Mirëpo, zgjedhjet nuk janë vetëm shtetërore ose komunale. Në shkollë është dashur të bëhet zgjedhja për lëndë zgjedhore. Ne kemi pasur disa lëndë si opsione, por më të përshtatshme dhe më atraktive për ne ishin lënda e astronomisë dhe ajo e aftësisë


për jetë. Arsyeja pse ne i zgjodhëm këto lëndë ishte sepse ne asnjëherë më parë nuk kishim pasur lëndë të tilla. Sidoqoftë, ne të gjithë jemi të kënaqur me përzgjedhjen tonë. Andaj, edhe ju të dashur lexues duhet të bëni zgjedhje me të cilat mund të ndiheni të kënaqur. Zgjedhjet janë vendim i së ardhmes sonë.



Autorët e artikullit të zgjedhjeve

## VENDI KU DISKUTOHET E ARDHMJA E KOSOVËS

AZEMINE (14), RINOR (14), LABIART (14), ARDENIS (14), GENTUAR (15), VENERA (13), ERBLINA (14),  
BLERONA (14)



**Të dashur lexues, ne e dijmë se ju keni mësuar më parë për Kuvendin e Kosovës. Por, ndoshta nuk keni pasur mundësi asnjëherë të mësoni për këtë temë nga nxënësit e Kosovës. Sot do ta keni këtë fat, sepse artikullin në duart tuaja e kemi shkruar ne, për ju**

Dëshirojmë të fillojmë këtë artikull duke treguar për kuptimin e fjalës Kuvend. Kjo fjalë në gjuhën shqipe do të thotë bashkëbisedim. Në Kuvendin e Kosovës bashkëbisedojnë 120 deputetë. Populli voton dhe zgjedh këta deputetë, ndërsa deputetët e zgjedhin Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe ministrat, si dhe Presidentin e vendit. Jo gjithë këta deputetë janë shqiptarë. Por, disa prej tyre janë qytetarë të komuniteteve jo shumicë. 10 janë serbë, kurse 10 të tjerë janë ashkalinjë, turq, romë, boshnjakë, goranë dhe egjiptianë. Në Kuvend duhet të jenë të pranishme edhe gratë. Prej 120 deputetëve, të paktën 30% të tyre janë gra. Në demokraci ne gëzojmë dy të drejta të rëndësishme. Ato janë e drejta për të zgjedhur, që nënkupton se ne mund të zgjedhim të tjerët. Ndërsa e drejta për t'u zgjedhur nënkupton se ne mund të kandidojmë dhe të bëhemi vetë deputetë. Këtë të drejtë e shfrytëzova unë kur kandidova për deputete në zgjedhjet e fundit parlamentare, që u mbajtën në muajin qershor. Pas këtyre zgjedhjeve, unë u bëra deputete, sepse fitova votat e popullit. Kjo do të thotë se unë tani i përfaqë-

soj qytetarët e mi. Detyrë tjetër imja është miratimi i ligjeve. Javën e kaluar kishim një seancë të rëndësishme plenare, pasi që votohej për ligjin për blerjen e pijeve alkoolike. Unë bashkë me të gjithë deputetët e tjerë votova pro këtij ligji. Ky ligj do të siguronte që t'i ndalonte fëmijët të blinin pije alkoolike në dyqane. Posaçërisht të konsumonin këto pije kaq të rrezikshme. Unë si deputete e Kuvendit duhet të kujdesem për shëndetin e të gjithë qytetarëve të mi dhe kjo është detyra më me peshë që unë kam. Këtë detyrë e ndaj me 119 deputetë të tjerë. Faleminderit që lexuat artikullin tonë. Ne shkruajtëm në emër të deputetës, pasi mësuam për Kuvendin. Përmes të gjitha shkrimeve dhe vizatimeve që do t'i shihni edhe në artikullin në vijim, ne shpresojmë që do ta kuptoni dëshirën tonë për të shpërndarë sa më shumë informata për këtë institucion. Besojmë që këtë ia kemi dalë!



Fytyrat e gazetarëve autorë



**Mos ndaloni së lexuari. Në vijim do të mund të mësoni për funksionet e Kuvendit të Kosovës. Lexim të këndshëm!**

Në përmbajtjen e këtij artikulli, kemi paraqitur në detaje funksionet e Kuvendit të Kosovës. I quajmë funksione pasi që ato janë role të përditshme të deputetëve. Këto role dhe detyra janë të parapara si me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, ashtu edhe me Kushtetutën e Kosovës. Po fillojmë tani.

Deputetët, që nga momenti i parë, prej të cilit bëhen deputetë ushtrojnë tri funksione kryesore. Ato janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe ai kontrollues. Funksioni përfaqësues përshkruan rolin e deputetëve, të cilin e marrin kur ata përzgjedhen nga qytetarët e Kosovës për këtë pozitë. Mandati i tyre, nëse nuk ka zgjedhje të parakohshme, zgjat 4 vjet. Kjo do të thotë se gjatë kësaj kohe, ata përfaqësojnë popullin. Është populli, ai i cili vetë i ka zgjedhur ata për të mbushur nevojat dhe interesat e tij, në emrin e tij. Funksioni legjislativ paraqet detyrën e rëndësishme të deputetëve, e cila lidhet me ligjet. Kuvendi është

i vetmi institucion, nga të gjitha institucionet e Kosovës, i cili ka të drejtë dhe për detyrë të miratojë dhe të nxjerr ligje të reja. Ligjet miratohen me pëlqimin apo aprovimin e më shumë se gjysmës së deputetëve, apo 61 deputetë.

Kurse, detyra e fundit, por jo më pak e rëndësishme është detyra apo funksioni kontrollues. Ky funksion do të thotë se Kuvendi detyrohet të bëjë një gjë shumë të rëndësishme. Ajo është kontrollimi i punës, të cilën e bën Qeveria. Ashtu siç e kemi cekur edhe në artikullin e mëparshëm, Kuvendi zgjedh Kryeministrin dhe ministrat të cilët punojnë në Qeveri. Pasi që janë deputetët ata të cilët zgjedhin këtë institucion, atëherë kontrollimin e punës së tyre mund ta bëjnë deputetët, të besuarit e popullit. Ky është fundi i kësaj gazeteje. Ne shpresojmë që këto informata nuk do të mbeten vetëm këtu, por ato do të prekin edhe shumë mendje të tjera.





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Nezë Bujani“  
Klasa: IX  
Vendi: Bujan, Lipjan